



WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



PARKU KOMBËTAR I DAJTIT

i arritshëm

destinacion turistik



tërheqës



Ky botim është përgatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, në kuadër të projektit:
"Parku Kombëtar i Dajtit një destinacion turistik i arritshëm dhe tërheqës",
i mbështetur nga nisma tripalëshe "Austerlitz/Slavkov" midis Austrisë, Çekisë dhe Sllovakisë

Përmbajtja, dizajn dhe faqosje



Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

Fotografitë e përdorura për këtë botim janë e drejtë e autorit:

- Shoqata Alpino Turistike Dajti (SHDAT)
- Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri

REC dhe SHDAT është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij botimi

Korrik 2016.





Të dashur fëmijë!

Parku Kombëtar i Dajtit është një nga zonat më të bukura natyrore të Tiranës, i cili me madhështinë e tij kërkon që gjithësecili prej nesh të kthejë sytë prej tij. Mali Dajtit nuk është vetëm pjesë e peizazhit të qytetit të Tiranës por ai është “mushkëria” e këtij ekosistemi të madh urban.

Ai ndodhet kaq pranë qytetit duke ofruar mundësi të shkëlqyera për ta vizituar, njohur, organizuar aktivitete sportive dhe edukuese për të rinjtë dhe të gjithë familjen.

Përmes këtij botimi, ne dëshirojmë t'ju mësojmë më shumë për këtë park, natyrën dhe se si të mund ta eksploroni atë në mënyrë të sigurtë. Në faqet e këtij botimi ju do të mund të merrni më shumë informacion në lidhje me shtigjet për ecje në Parkun Kombëtar të Dajtit? Do të mësoni se si të përzgjidhni shtegun më të përshtatshëm? Si të kuptoni sinjalistikën për të ecur në mal? Çfarë përfitimesh shëndetësore na sjell ecja në natyrë? Çfarë veshjesh dhe pajisjesh duhet të kemi me vete kur duhet të shkojmë në një ekspeditë në natyrë?

Por në fund të fundit ky botim ju ndihmon të bëheni më të ndërgjegjshëm për të kuptuar se kush jemi ne dhe cilat janë lidhjet tona me Parkun Kombëtar të Dajtit dhe natyrën. Duke ecur në shtigjet e këtij parku apo duke eksploruar ekositemet e tij, por dhe duke biseduar me shokët dhe prindërit, ju mund të mësoni më shumë për kafshët, pemët, lulet, zogjtë, fluturat dhe çdo gjë të bukur që natyra përreth nesh na ofron përzemërsisht.



"MUSHKËRIA" E QYTETIT PARKU KOMBËTAR I DAJTIT

PARKU KOMBËTAR I DAJTIT është shpallur Park Kombëtar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 21.6.2006 "Për shpalljen e ekosistemit natyror të Malit të Dajtit "Park Kombëtar" (me sipërfaqe të zgjeruar)" i ndryshuar. Sipërfaqja aktuale e këtij Parku është 29.217 HA.

Në bazë të Ligjit për Zonat e Mbrojtura, Parku i përket Kategorisë II të Zonave të Mbrojtura.

Si rrjedhojë, në Parkun e Dajtit zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes dhe janë të ndaluara ushtrimi i disa aktiviteteve, si:

- (i) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive;
- (ii) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitet;
- (iii) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e gazit, etj.

PARKU KOMBËTAR I DAJTIT

...ka vlera peizazhore, çlodhëse, argëtuese, kulturore, historike e tradicionale, por dhe vlera shkencore dhe didaktike.

Parkut Kombëtar i Dajtit fillon me një shtrirje gjeografike në veri me masivin e Qafshtamës, në lindje me masivin e Malit me Gropa, në jug me Bizë të Martaneshit dhe në perëndim me shtrirje gjatësore me kryeqytetin, pra në konceptin turistik jo atë administrativ është parku më i madh pranë zonave urbane në Shqipëri. Përgjatë Parkut Kombëtar të Dajtit ka rreth 33 vendbanime dhe fshatra, me një popullsi totale prej 15.000 banorësh. Banesat e fshatrave janë tërheqëse dhe kanë strukturë tradicionale.

Parku Kombëtar i Dajtit dallohet për një numër të madh Monumentesh Natyrore, si: *Gjeomonumenti i Karstit të Malit me Gropa*, *Biomonumenti i Rrapit të Kranës* - pranë fshatit Priskë e Madhe, *Gjeomonumenti Shkalla e Tujanit*, *Gjeomonumenti Shpella e Zezë ose e Pëllumbasit* etj.



NATYRA NUK ËSHTË NJË VEND PËR T'U VIZITUAR... AJO ËSHTË SHTËPIA JONË

Sot, më shumë se kurrë më parë, ekosistemet natyrore dhe shumëllojshmëria biologjike janë nën një rrezik serioz. Rreth 50.000 lloje biologjike kanë filluar të zhduken çdo vit. Për herë të parë në historinë e natyrës, një lloj specifik, me emrin *Homo sapiens* (njeriu) është bërë një faktor i fuqishëm në shkatërrimin e ekuilibrit natyror. Në nivel botëror, numri i llojeve të shpendëve është duke u zvogëluar, ndërkohë që 1/4 e të gjithë gjitarëve është nën një rrezik serioz zhdukjeje.

PSE NATYRA ËSHTË E RËNDËSISHME ?

ÇFARË NA JEP NATYRA?

- Natyra na jep lëndën e parë – ushqimet, lëndën drusore, produktet e pyllit, barnat mjekësore, etj.
- Natyra siguron habitatin ku jetojnë organizmat e gjallë.
- Natyra mundëson dhe realizon polenizimin e bimëve.
- Natyra siguron kontrollin biologjik ndaj sëmundjeve dhe epidemive.
- Natyra riciklon mbeturinat natyrore, zbut ndotjen dhe mirëmban tokën.
- Natyra furnizon zinxhirin ushqimor dhe rregullon ciklin e lëndëve që qarkullojnë në të.
- Natyra rregullon të gjitha proceset atmosferike, ciklin natyror të ujit dhe të gjitha dukuritë natyrore.
- Natyra është një vend për t'u çlodhur dhe për t'u argëtuar, vend kulture, mjet edukimi dhe kërkimi shkencor.



LOJA E NATYRËS



Loja fillon me ndarjen e roleve midis fëmijëve. Një fëmijë është "dielli", disa janë "mikroorganizmat", ndërsa të tjerët janë bimë dhe kafshë të ndryshme. *Fëmijët e dinë se sa shumë i rëndësishëm është dielli për jetën në tokë.*


Rrezatimi diellor direkt do të kapet nga bimët, sepse vetëm bimët mund ta përthithin energjinë diellore dhe pastaj ta shndërrojnë në një formë, të cilën organizmat e tjerë e shfrytëzojnë si energji. Çdo anëtar i ri le të marrë një pjesë nga litari i gjatë. Ata do të lidhen si në zinxhirin ushqimor. Duhet të ketë shumë lidhje midis organizmave të ndryshëm — p.sh. të gjitha bimët të jenë të lidhura me diellin.

Pasi ta formoni zinxhirin, tregojuni fëmijëve se po vjen dimri i ftohtë, i cili do të shkatërrojë disa prej bimëve, prandaj ata nxënës do të duhet të ulen. Pas dimrit, minjtë dhe larvat (ose kafshët e tjera) nuk kanë ushqim të mjaftueshëm dhe ngordhin, prandaj edhe ata nxënës ulen etj. Së shpejti, të gjithë do të ulen, përveç Diellit, tokës, ujit, ajrit dhe mikroorganizmave. Mikroorganizmat mund të kërcëjnë lart e poshtë për të treguar se sa janë të lumtur që kanë ushqim të mjaftueshëm.

Tregoni si mikroorganizmat do të zbërthejnë trupat në lëndët bazë, të cilat do ta pasurojnë tokën. Bimët sërisht do të rriten, dhe larvat do të kenë çfarë të hanë. Kështu secili fëmijë do të ngrihet ashtu siç lloji i vet kthehet në jetë pas ndyshimit.

Bisedoni me shokët se si çdo organizëm i gjallë është një lloj i rëndësishëm në zinxhirin ushqimor. Theksoni faktin se zhdukja e një lloji ndikon në ekzistencën e llojeve të tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë të lidhura me të. Njeriu, me sjelljen e vet, duhet të ndihmojë për ruajtjen e llojeve të ndryshme të botës së gjallë.





Pylli është një nga ekosistemet më të rëndësishme të Parkut Kombëtar të Dajtit. Përveç peizazheve të bukura me shumë lule të egra, ky park është shtëpia e shumë gjitarëve, ku veçojmë praninë e ujkut, ariun e murrmë, derrin e egër, kunadhen dhe macen e egër.

Parku Kombëtar i Dajtit strehon rreth 133 lloje kafshësh dhe insektesh, ku rreth 23 prej tyre janë të një rëndësie globale

MONUMENTE NATYRE

SHPELLA E ZEZË OSE E PËLLUMBASIT

Shpella e Zezë ose e Pëllumbasit është nga monumentet më interesante të natyrës që gjendet brenda Parkut Kombëtar të Dajtit. Ajo është një shpellë karstike me përmasa rreth 360 m e gjatë, 10 - 15 m e gjerë dhe 15 - 45 m e lartë, me mjedise të mbushura me stalaktite dhe stalagmite.

Shpella e Pëllumbasit, siç na pëlqen ta quajmë më shpesh përbën një objekt me vlera për t'u vizituar sepse është objekt i rrallë për speleologjinë shqiptare. Ajo ndodhet rreth 25 km në juglindje të Tiranës brenda Parkut Kombëtar të Dajtit, në grykën e Skoranës, që përshkohet nga lumi Erzen. Shpella është e mbushur me mikroforma të shumta të relievit nëntokësor karstik me bukuri të rrallë dhe vlera të veçanta turistike.

Eksplorimet e kryera vitet e fundit në bashkëpunim me grupe speleologësh nga Italia, kanë evidentuar vlera të shumta shkencore dhe turistike me rëndësi ndërkombëtare. Aty janë gjetur skelete të arinjve të shpellave (*Ursus speleaus*), që kanë jetuar nga 10.000 deri në 400.000 vjet më parë. Po sipas tyre në gjithë Evropën janë vetëm pesë shpella të tilla, të cilat, pas studimeve të hollësishme, u kthyen në muze, ndërsa zonat përreth tyre në parqe kombëtare. Ndryshe nga simotrat evropiane, Shpella e e Pëllumbasit, ka edhe mbetje të kulturës humane, të cilat, sipas konfirmimit të Institutit të Arkeologjisë, iu përkasin periudhës nga Paleoliti në Mesjetën e Hershme.

Për të shkuar tek Shpella e Zezë ndiqet rruga Tiranë – Elbasan deri në Ibë. Më pas ndiqet ajo që të çon në fshatin Pëllumbas. Prej kësaj të fundit, për të arritur deri në shpellë, ndjek një rrugë këmbësorësh, por për arsye sigurie gjithmonë është e rekomandueshme që të jemi të shoqëruar nga guida turistike.



A E DINI?
STALAKTITET
RRITEN ME VETEM
0,13 MM NË VIT



SHPELLAT JANË “SHTËPI” ME NJË BIODIVERSITET TË PASUR

Banorët e përhershëm të tyre janë lakuriqët, të cilat janë të vetmit gjitarë që arrijnë të fluturojnë me anë të gjymtyrëve të përparme. Shumë lloje lakuriqësh janë të kërcënuar. Kërcënimi vjen nga prishja e habitatit, apo strehës së kolonive, si dhe nga shfrytëzimi intensiv i territorit, gjë që çon në rritjen e niveleve të ndotjes dhe në rrallimin e popullatave të insekteve me të cilat ushqehen lakuriqët.



BANORËT E SHPELLAVE!

Lakuriqët ushqehen kryesisht me insekte. Shumë nga llojet e lakuriqëve jetojnë në koloni dimërore në të cilat flenë ose koloni verore në të cilat riprodhohen. Thuajse të gjitha llojet dalin vetëm natën. Lakuriqët përdorin ekolokacionin për të naviguar dhe për të gjetur prentë. Kjo do të thotë se lakuriqët nxjerrin tinguj me frekuencë të lartë dhe dëgjojnë jehonën e zërit të tyre për të përcaktuar vend-ndodhjen e objekteve.

Femrat e lakuriqëve përgjithësisht lindin një pasardhës në çdo lindje. Ato i ushqejnë të vegjlit për 6-8 javë, derisa sa të arrijnë përmasat e të rriturve, sepse krahët e lakuriqëve në momentin e lindjes janë shumë të vegjël. Jetëgjatësia mund të shkojë më shumë se 16 vjet.



DAJTI ËSHTË GATI PËR T'U PËRQAFUAR! SINJALISTIKA PËR ECJE NË MAL

ÇFARË TREGON KJO SHENJË?



Ngjitja në mal (*hiking*) është një nga aktivitetet fizike më të thjeshta për të apasionuarit e natyrës. Shtigjet/rrugëtimet në malin e Dajtit kanë shkallë të ndryshme vështirësie, prandaj përpara se të nisemi duhet të shikojmë me kujdes hartën e shtigjeve të "Parkut Kombëtar të Dajtit".

Të gjitha shtigjet janë të shënuara me një shenjë të kuqe dhe të bardhë, ashtu siç tregohet dhe në figurat e kësaj faqeje. Kohët e fundit disa prej këtyre shtigjeve janë rishënuar për t'i bërë ato më të dukshme dhe interesante për vizitorët dhe turistët. Megjithatë mënyra më e mirë për të marrë informacion mbi shtigjet/rrugëtimet dhe pikënisjen e tyre është që të pyesni një nga guidat lokale.




Në Parkun Kombëtar të Dajtit ka rreth 25 shtigje, të cilat janë shënuar nga anëtarët e Shoqatës Dajti Alpino Turitik. Rrugëtimi i vargmalit të Dajtit ka 12 shtigje fantastike për të gjitha moshat dhe mundësitë, sepse mali është për të gjithë dhe i të gjithëve, përmendim Shtegun e Tujanit, Linzës, Gurorja e vjetër, Tubat e ujit, Kreshta e Dajtit, Unaza e Dajtit etj.

Por ky park ofron argëtim gjithëpërfshirës për të gjitha llojet e sporteve si me biçikleta, alpinizëm, kampingje me çadra dhe rulota, ecje e shëtije në mal, kacavjerrje dhe me e rëndësishmja është ajo e turizmit familjar për fundjavë .

Koncepti i shënimit të shtigjeve është njohja e natyrës dhe zhvillimi i një turizmi të përgjegjshëm jo vetëm për vizitorët e huaj por më shumë për ata vendas.

CILIN RRUGËTIM DUHET TË NDJEK?





NJOHJA E SHTIGJEVE

- Shtigjet e ecjes (marshimit) janë të dizenuara në mënyrë specifike për të udhëtuar në këmbë. Shtigjet rurale janë të dizenuara në mënyrë tipike të jenë sa më pak ndërhyrëse mbi mjedisin natyror dhe për këtë arsye shpesh kanë shumë pak shenja të cilat janë shumë të thjeshta. Përgjatë shumë shtigjeve rurale ecjeje, vulat apo shenjat janë lloji i vetëm i sinjaleve të përdorura, përveç shenjave me drejtime në kryqëzimet e shtigjeve. Për të shënuar dhe për të sinjalizuar shtigje të caktuara me distancë të largët, ndiqni udhëzimet e miratuara nga agjencia menaxhuese apo organizimin e shtegut për çdo shteg të veçantë.
- Shtigjet për biçikleta malore janë të dizenuara në mënyrë tipike për përdorim me ndikim të ulët dhe mund të shkojnë nga përdorimi i përgjithshëm deri tek i vështiri. Përveç shenjave dhe sinjalistikës rregullatore që i mbajnë çiklistët në rrugën e caktuar të shtegut, shtigjet për biçikletat malore mund të përfshijnë edhe shenjat që vlerësojnë nivelin e vështirësisë së shtegut.
- Shtigjet interpretuese janë shtigje për këmbësorë të dizenuara për interpretimin e tipareve natyrore dhe kulturore në peizazh. Ato janë relativisht të shkurtra dhe janë shpesh të shtrua si shtigje të lakuara. Shtigjet interpretuese janë shpesh të ngjashme me shtigjet e gjelbra në ndërtim dhe shpesh janë të arritshme dhe nga personat me aftësi të kufizuara, por nuk janë të dizenuara për turizëm masiv. Shtigje interpretuese zakonisht kanë një gradë shumë të butë vështirësie dhe janë të përcaktuara për shëtitës me një ritëm mesatar.
- Shtigjet natyrore janë shtigje interpretuese projektuar për të edukuar përdoruesit në lidhje me karakteristikat natyrore, historinë natyrore, ose për florën apo faunën përgjatë shtegut.







NGJITJE NË MALIN E DAJTIT

GURORE E VJETËR - TUBAT E UJIT - KALAJA E DAJTIT

<i>Karakteristikat e rrugëtimit</i>	Tur malor. Përshkohet peizazh i mrekullueshëm natyror, i shoqëruar me gjelbërim përgjatë gjithë lëvizjes.
<i>Mënyrat e lëvizjes përgjatë rrugëtimit</i>	Turi realizohet më këmbë, por pjesërisht dhe me biçikletë.
<i>Shkalla e vështirësisë së rrugëtimit</i>	Terren i lehtë dhe i moderuar
<i>Mosha e këshilluar</i>	Mbi 12 vjeç
<i>Pikat tërheqëse që mund të vizitohen</i>	Kalaja e Dajtit ndodhet në shpatin perëndimor të Malit të Dajtit, mbi një majë në të djathtë të rrugës që të çon nga King Parku (ish – Kampi i Punëtorëve) për në restorantin Gurra e Perrisë. Duke qenë në një lartësi rreth 1200 m mbi nivelin e detit, prej saj mund të vrojtohet një horizont shumë i gjerë që përfshin fushën e Tiranës, vargjet kodrinore rreth saj e deri në bregdet.
<i>Zona me rëndësi</i>	Përgjatë lëvizjes nuk ka burime uji, restorante apo objekte të tjera. Vetëm tek antenat ndodhet një godinë për administrimin e antenave.
<i>Përshkrimi i rrugëtimit</i>	Fillimi i këtij rrugëtimi bëhet nga Gurorja e Vjetër, për të vazhduar nga ana jugore e saj me daljen në fushë Surrel. Aty janë dy tuba të mëdhenj, të cilët mund t'i ndjekësh përgjatë rrugëtimit. Mund të ecësh dhe mbi tuba si pjesë e pikave tërheqëse në zonë, por kjo nuk është e përshtatshme për të gjitha moshat pasi përbën rrezik ecja mbi tuba. Tek stacioni i pompave merr përsëri rrugën derisa del në rrugën me asfalt të Dajtit dhe vazhdon shtegun që të çon për në Kalanë e Dajtit.







NGJITJE NË MALIN E BRARIT

Karakteristikat e rrugëtimit

Tur më këmbë, me reliev të kombinuar kodrinor e malor.

Mënyrat e lëvizjes përgjatë rrugëtimit

Turi realizohet vetëm me ecje në këmbë për të gjitha moshat.

Shkalla e vështirësisë së rrugëtimit

Terren i lehtë dhe pjesërisht i moderuar

Mosha e këshilluar

Mbi moshën 10 vjeç

Pikat tërheqëse që mund të vizitohen

Turi përshkohet nga një peizazh i veçantë pasi rrugëtimet për në majë bëhen nga dy drejtime të ndryshme. Nga maja e malit shikohet kryeqyteti i Tiranës, por dhe nga mbrapa tij, në pjesën lindore, shfaqet një peizazh i mrekullueshëm natyror, me gjelbërim të vazhdueshëm.


Zona me rëndësi

Përgjatë lëvizjes më këmbë nuk ka burime uji. Në Brar ka restorante me gatime tradicionale të zonës. Fshati Brar mund të shërbejë si vend strehimi dhe pushimi një ditore.

Përshkrimi i rrugëtimit

Shumë banorë të Tiranës, por edhe të tjerë shqiptarë apo të huaj, e kanë soditur zonën e Brarit, i njohur për kanionet e tij që kalojnë përgjatë rrugës së Arbërit, nga ura e Brarit deri në Zall Dajt. Turi kombinohet dhe me peizazhin malor të Brarit dhe kureshtia i ka shtyrë njerëzit ta vizitojnë atë më këmbë, me biçikletë apo dhe me mjete motorike. Mjedis natyror mrekullueshëm, me gjelbërim të vazhdueshëm dhe shijimi i gatimeve tradicionale i ka bërë njerëzit që të rikthehen herë pas here në zonën e Brarit.















NJOHJA E SHENJAVE PËR ECJE NË MAL

Shenjat orientuese janë të thjeshta, të kuptueshme për të gjithë. Ngjyra të ndezura, tabelat informuese të vendosura në cdo fillim shtegu, në harmoni me natyrën duke kombinuar materiale druri me pak metal, të arritshme nga të gjithë, të studiuara nga alpinistë profesionistë, me qëllim që çdokush që shkon për herë të parë në mal të mund të orientohet lehtësisht.

-  Ture alternative me këmbë
-  Ture kryesore me këmbë
-  Ture alternative me bicikleta
-  Ture kryesore me bicikleta

-  Kjo shenjë tregon fillimin e turit me bicikletë
-  Kjo shenjë tregon mbarimin e turit me bicikletë
-  Kjo shenjë tregon fillimin e turit me këmbë
-  Kjo shenjë tregon mbarimin e turit me këmbë



16

-  Ecje në mal
-  Ngjitje shkëmbore
-  Kujdes kafshët e egra
-  Nuk lejohet ndezja e zjarrit
-  Monument arkeologjik
-  Peisazh

Shenja drejtuese për ecje në mal



Këto shenja i gjeni kryesisht në gurë dhe trunje pemësh



Kjo shenjë tregon vendqëndrim/vendpushim



Tabela informuese

Këto tabela i gjeni kryesisht në fillim të shtegut



Tabela orientuese

Këto tabela i gjeni kryesisht përgjatë rrugëtimit në shteg

KËSHILLA TË DOBISHME PËR TË SHIJUAR NATYRËN



Ecja në mal është një nga aktivitetet fizike më të këndshme për njerëzit. Megjithatë, siç do sport tjetër dhe ai ka potencialet e veta të rrezikshmërisë, prandaj përpara se të niseni për një udhëtim në mal do t'iu këshillojmë për të marrë masat paraprake të nevojshme:

- Kur niseni për në mal, mos shkoni asnjëherë vetëm. Tregojini gjithmonë dikujt tjetër ku po shkoni dhe kur pritet që të ktheheni përsëri, në mënyrë që ata mund të organizojnë një kërkim në qoftë se jeni vonuar më shumë se sa duhet. Natyra ofron dhe të papritura dhe shpesh telefonat celular mund të mos ofrojnë shërbime në shumë nga zonat e shtigjeve në mal.
- Merrni ujë, për të shmangur rreziqet nga dehidratimi. Dëshira për të pirë ujë është alarm i trupit ndaj mungesës së tij. Pini pak e herë pas here.
- Merrni ushqim (ose të paktën diçka për të siguruar kalori, një çokollatë do të ishte gjithmonë një ushqim i përshtatshëm për në mal), kështu që ju nuk do t'ju bien "të fikët nga uria"!
- Vishuni me kujdes. Në varësi të sezonit, ju mund të keni nevojë për mbrojtje kundër të ftohtit ose lagështisë. Kjo mund të bëhet shumë e rëndësishme në qoftë se ju plagoseni dhe duhet të prisni që dikush të vijë t'iu shpëtojë! Mos vishni këpucë të holla, të cilat mund të prishen dhe t'ju shkaktojnë probleme! Mundohuni që këpucët sportive të jenë me qafë, duke mbuluar pjesën e kavigjës.
- Mbrohuni kundër diellit, me një kapele dhe krem mbrojtës. Edhe në një ditë me vranësira ju mund të digjeni nga dielli. Njerëzit flasin për "djegjen e erës", por në fakt ajo që ju dëmton është drita ultravjollcë, që vjen përmes reve.
- Mbroni veten nga insektet. Në kohë të caktuara të vitit, "mushkonjat", mund të jenë një problem i madh, kështu që "mbulohuni" dhe / ose përdorni një ilaç efektiv kundër insekteve!
- Në mal ecet gjithmonë me ritmin e më të ngadaltit.



PARIMET ETIKE PËR TË MOS LËNË GJURMË NË NATYRË

PLANIFIKONI NË KOHË DHE PËRGATITUNI

- Njihuni me rregullat dhe karakteristikat e veçanta të zonës që ju do të vizitoni.
- Përgatituni për motin ekstrem, rreziqet e mundshme dhe emergjencat.
- Organizoni vizita në grupe të vogla, kur është e mundur.
- Ripaketoni ushqimin për të minimizuar mbetjet.
- Përdorni një hartë, busull dhe mësoni të njihni sinjalistikën në mal (shënimet me bojë/tabelat).

LËRENI SI E GJETËT

- Mos dëmtoni monumentet e trashëgimisë historike, kulturore dhe natyrore.
- Mos shkelini qilimin e gjelbër natyror me makina.
- Shmangni futjen apo transportimin e llojeve jo-vendase.

MINIMIZONI NDIKIMET NGA ZJARRI NË KAMP

- Zjarret në kamp mund të shkaktojnë ndikime afatgjata në zonë.
- Për të ndezur zjarrin përdorni vetëm shkopinj të marrë në tokë, të cilët mund të thyhen me dorë.
- Përpara se të largoheni, digjni të gjithë drutë dhe qymyrin derisa të bëhen hi, prisni derisa zjarri të fiket plotësisht, më pas shpërndani hirin e ftohtë.





ECNI DHE NGRINI KAMPIN NË SIPËRFAQE TË QËNDRUESHME

- Sipërfaqet e qëndrueshme përfshijnë shtigje të përcaktuara për të ecur, zona kampimi, shkëmbinj, zhavorr, kullota të thata apo dëborë.
- Mbroni zonat ujore, duke ngritur kampe të paktën 200 hapa larg nga liqenet dhe përrenjtë.
- Zonat e mira për kampim gjenden në natyrë, ato nuk krijohen apo ndërtohen.
- Përqendrohuni në përdorimin e shtigjeve dhe zonat ekzistuese për kampim.
- Ecni në rrjesht për një, në mes të shtegut, edhe kur ka lagështirë apo baltë.
- Mbani zonën e kampimit në një sipërfaqe të vogël. Fokusoni aktivitetin në zona ku mungon bimësia Shmangni krijimin e shtigjeve apo zonave të reja të kampimit.



LINI TINGUJT E NATYRËS TË MBIZOTËROJNË. SHMANGNI ZHURMAT

HIDHNI MBETJET NË MËNYRËN E DUHUR

- Paketojini nga brenda dhe jashtë.
- Kontrolloni kampin tuaj dhe pjesën tjetër të zonës për mbetje apo ushqime të hedhura kuturu.
- Mblidhni të gjitha mbetjet, ushqimet e mbetura dhe paketimet e përdorura.

RESPEKTONI JETËN E EGËR

- Vëzhgoni kafshët e egra nga distanca. Mos i ndiqni apo mos u afroni pranë tyre.
- Asnjëherë mos i ushqeni kafshët. Të ushqesh një kafshë të egër i dëmton shëndetin, i ndryshon sjelljen e saj natyrore dhe e ekspozon ndaj grabitqarëve dhe rreziqeve të tjera.
- Shmangni afrimin të kafshët e egra gjatë kohës së ndjeshme për ta, si çiftëzimi, folenizimi, rritja e të vegjëlve apo periudha e letargjisë.



**MOS MERR ASGJË,
VEÇ FOTO**

**MOS LËR ASGJË,
VEÇ GJURMËVE TË KËMBËS**

**MOS VRIT ASGJË,
VEÇ KOHËN**

